

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20, 77/21, 154/23, 55/24 dhe 193/24), dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët 1 dhe 3 nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për ndërmarrjen e masës (Tekst i pastruar) ark.nr.01-4139/1, datë 07.11.2022, Raport me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark. nr.10-1256/1 datë 25.03.2025 dhe Konkluzionin ark. nr.02-1670/4, datë 10.04.2025, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizive, në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, miratoi si vijon:

Aktvendim
për ndërmarrjen e masës – paralajmërim publik

1. PUBLIKISHT PARALAJMËROHET Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) KLAN MAQEDONI eksport - import Saraj Shkup, për shkak të shkeljes së nenit 92, paragrafët 1 dhe 3 të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV), të mënyrës që transmetuesi në kuadër të shërbimit programor televiziv, më 5 mars 2025, nuk ka transmetuar së paku 30% të programit të krijuar burimot si vepra audiovizive maqedonase, dhe as gjysmën e minimumit program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, të transmetuar në periudhën nga ora 7:00 deri në 19:00.

Shkelja nga paragrafi (10) i kësaj pike është përcaktuar në Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark. nr.10-1256/1 datë 25.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

2. URDHËROHET që SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport - import Saraj Shkup, në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktvendimi, të harmonizojë punën e tij me dispozitat e LSHMAAV.

3. Pas skadimit të afatit të përcaktuar në pikën 2 të këtij aktvendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij Aktvendimi, ka vepruar sipas Aktvendimit.

4. Ky Aktvendim është përfundimtar dhe dita e miratimit të tij llogaritet dita e certifikimit në Arkivin e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia).

A r s y e t i m

Agjencia, në bazë të nenit 28 të LSHMAAV, është kompetente për të kryer mbikëqyrje programore (monitorim) të programeve të transmetuesve dhe ofruesve të shërbimeve mediatike audiovizive sipas kërkesës, si dhe të paketave programore të ritransmetuara nga operatorët e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike nga aspekti i pajtueshmërisë me dispozitat e Ligjit në fjalë, lejeve, certifikat e dhëna për regjistrim, akteve nënligjore dhe akte të tjera të miratuara nga Agjencia.

Në përputhje me nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 1 të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë ndaj botiesi të medias (transmetuesi) ndërmerr masë - paralajmërim publik në rastet kur është kryer shkelje ose shkelje e dispozitave të LSHMAAV dhe akteve nënligjore të miratuara në bazë të Ligjit të njëjtë, si dhe kushteve dhe detyrimeve të përcaktuara me leje dhe akte tjera të Agjencisë.

Në përputhje me nenin 92, paragrafët 1 dhe 3 të LSHMAAV, Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive janë të detyruara gjatë ditës të transmetojnë së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audio ose audiovizuele maqedonase, ndërsa shërbimi transmetues publik së paku 40%. Shoqëritë Tregtare Radiodifuzive që transmetojnë shërbime programore televizive janë të detyruara të përmbushin së paku gjysmën e detyrimeve nga paragrafi (1) i këtij neni në periudhën prej orës 07:00 deri në ora 19:00.

Në kuadër të kompetencave ligjore, Agjencia, nëpërmjet Sektorit për çështjet programore, me datë 24.03.2025, ka kryer mbikëqyrje të rregullt programore (monitorim), ku është konstatuar se me datë 05.03.2025, shërbimi programor televiziv i SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport - import Saraj Shkup,, nuk ka transmetuar së paku 30% program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, as nuk ka transmetuar së paku gjysmën e minimumit ligjor program të krijuar burimor si vepra audiovizive maqedonase, të transmetuar në periudhën prej orës 7:00 deri në ora 19:00.

Përkatësisht, me mbikëqyrjen është konstatuar se më 5 mars 2025, shërbimi programor televiziv i Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, ka transmetuar

42 minuta dhe 1 sekondë program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që është **3,27%** e totalit të programit të transmetuar gjatë ditës që përfshihet në llogaritjen e programit të krijuar burimor (21 orë 25 minuta dhe 55 sekonda). Minimumi ligjor prej 30% për transmetim të programi të krijuar burimor gjatë një dite, në raport me totalin e programit të transmetuar më 5 mars që hyn në llogaritjen për program të krijuar burimor (21:25:55), është 6 orë 25 minuta e 46 sekonda. Televizioni KLAN ka transmetuar për 5 orë 43 minuta dhe 45 sekonda më pak program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase.

Gjysma e minimumit ligjor (nga 06 : 25 : 46) është 3 orë 12 minuta dhe 53 sekonda program të krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, shuma minimale që është dashur të transmetohet në programin e Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive KLAN MAQEDONI, në periudhën prej orës 7:00 deri në orën 19:00. Gjatë kësaj periudhe, siç është konstatuar nga mbikëqyrja, janë transmetuar 25 minuta dhe 49 sekonda program i krijuar burimor si vepra audiovizuele maqedonase, që në këtë situatë është për 2 orë 47 minuta dhe 4 sekonda më pak se minimumi i kërkuar.

Shkelja nga pika 1 e këtij Aktvendimi është përcaktuar në Raportin me Shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1256/1, datë 25.03.2025, që është pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi si Shtojcë nr. 1.

Në pajtim me nenin 23, paragrafi (3) të LSHMAAV, Këshilli i Agjencisë drejtuar SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, me datë 26.03.2025, ka dërguar Shkresë ark.nr. 10-1256/2 datë 26.03.2025, me të cilën i dërgoi dhe Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1256/1 datë 25.03.2025, që në fat prej 7 (shtatë) ditësh nga dita e pranimit të shkresës, drejtuar Këshillit të Agjencisë të dorëzon deklaratë me shkrim për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Shkresa u pranua në mënyrë të rregullt nga transmetuesi më 27.03.2025. Në afatin e parashikuar, SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup, nuk u deklarua për shkeljen e kryer të dispozitave të LSHMAAV. Këshilli i Agjencisë në seancën e mbajtur më 10.04.2025, e shqyrtoi Raportin me shkrim në fjalë dhe konstatoi që SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup t'i shqiptoi masë-vërejtje publike.

Rrjedhimisht, në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 20 dhe neni 23 paragrafi (1) nënparagrafi 1 të LSHMAAV, dhe në lidhje me nenin 92 paragrafët 1 dhe 3 nga Ligji i njëjtë, pika 6 dhe pika 14 të Udhëzimit për përcaktimin e afatit për veprim sipas aktvendimeve të Agjencisë për marrjen e masave, Raportin me shkrim për mbikëqyrje të kryer programore ark.nr.10-1256/1 datë 25.03.2025, për konstatim të mosrespektimit të dispozitave të LSHMAAV, përcaktuar në pikën 1 të këtij Aktvendimi, Këshilli i Agjencisë në seancën e 16-të mbajtur më 10.04.2025, në pajtim me Konkluzionin ark.nr.02-1670/4 datë 10.04.2025, miratoi Aktvendim ku publikisht paralajmëron SHTR KLAN MAQEDONI SHPKNJP eksport-import Saraj Shkup dhe urdhërohet që në afat prej 20 (njëzet) ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit të harominozohë punën e saj me dispozitat e LSHMAAV. Pas skadimit të afatit përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi, të kryhet mbikëqyrje kontrolli për të përcaktuar nëse subjekti i mbikëqyrur, i cekur në pikën 1 të këtij aktvendimi, ka vepruar sipas aktvendimit.

Në pajtim me nenin 24, paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit për Media, ky Aktvendim është përfundimtar dhe kundër këtij aktvendimi transmetuesi ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Bazuar nga sa më sipë u mor vendim si në dispozitiv.

Shtojcë (1):

- 1) Raport me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer programore ark.nr.10-1256/1 datë 25.03.2025.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuele
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi transmetuesi mund të ngrejë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i aktvendimit.